



MBI PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË KONKURSION NDËRKOMBËTAR TË PIANISTËVE TË RINJ NË MOSKË, RUSI

Qendra Ndërkombëtare Artistike e Moskës organizon Konkursin e III Ndërkombëtar të Pianistëve të rinj “Vladimir Krainev” në Moskë. Qëllimi i këtij konkursi është të identifikojë dhe të promovojë pianistë të rinj të talentuar, të mbështesë dhe të inkurajojë zhvillimin harmonik të aftësive të tyre artistike, të adresojë vëmendjen e gjeneratave të reja në vlerat kulturore dhe sociale, si dhe të forcojë marrëdhëniet kulturore ndërkombëtare mes vendeve të ndryshme të botës. Pjesëmarrësit në këtë konkurrim do të ndahen në 3 kategori sipas grup moshave në vijim:

- Fëmijë të moshës 8-12 vjeç;
- Të rinj të moshës 13-16 vjeç;
- Të rinj të moshës 17-22 vjeç;

Organizatorët marrin përsipër për kandidatët e pranuar të gjitha shpenzimet e pjesëmarrjes: shpenzimet për transportin ndërkombëtar, shpenzimet e ushqimit, akomodimit, si dhe të transportit të brendshëm.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe kushteve që duhet të plotësojë kandidati, ju lutemi referojuni materialit informativ bashkëlidhur, i cili gjendet gjithashtu në adresën web:

www.krainevcompetition.com.

e-mail: info@krainevcompetition.com

Phone: +7 (495) 730 7056

+7 (968) 071 6597

Afati i fundit i aplikimit për pjesëmarrje në këtë konkurs ndërkombëtar është data **31 tetor2018**, ndërsa faza finale e recitaleve dhe interpretimit me orkestër do të mbahet në Qendrën Ndërkombëtare Artistike të Moskës në datat **27 mars-1 prill 2019**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS